



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2014

Proces-verbal
i
Mbledhjes së Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së

I mbajtur sot në datën 21.02.2014, me pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, ku i pranishëm është edhe Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Rudi Bobrati..

Verifikohet prezenca e anëtarëve. Present ne këtë mbledhje janë këta anëtarë:

1. Z. Lutfi DERVISHI
2. Znj. Delina NANO
3. Z. Altin GOXHAI
4. Znj. Majlinda DHUKA
5. Znj. Itena NDROQI
6. Znj. Gelardina PRODANI
7. Znj. Elira KOKONA
8. Z. Adrian THANO

Mungon anëtari i Bordit, z. Henri Çili.

Rendi i ditës është zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarit të ri të Bordit Mbikëqyrës.

Në bazë të nenit 11, pika 5, e VKM nr. 769 datë 15.07.2009 “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, e ndryshuar, në mungesë të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të këtij bordi, fjalën e mori anëtari më i moshuar, present në këtë mbledhje, z. Lutfi Dervishi, i cili parashtrroi:

- *Fillimisht dua të falënderoj punën e kryer deri më tani, nga ana e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, veçanërisht Drejtorin Ekzekutiv, Rudi Bobrati, për veprimtarinë e tij të palodhur, profesionale e të suksesshme.*
- *Referuar rendit të ditës, sot mund të kalojmë në zgjedhjen e kryetarit të ri të Bordit Mbikëqyrës, vend i cili është lënë vakant nga moment i dorëheqjes së ish-Kryetares së këtij Bordi , znj. Mira Meksi.*
- *Të kalojmë në propozimin për anëtarin që do të marri këtë detyrë. Ka ndonjë nga anëtarët present, një propozim konkret?*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Fjalën e mori anëtarja e Bordit Mbikëqyrës, znj. Itena Ndroqi:

- *Unë propozoj për pozicionin e kryetarit të këtij bordi z. Adrian Thano.*

Fjalën e mori, anëtari i bordit, z. Altin Goxhaj, i cili parashtroi:

"Une mendoj se z. Thano i plotëson të gjitha kushtet me përjashtim të faktit se vendosja në krye të Bordit të një personi me angazhim të hapur politik të njeanshem e demton kredibilitetin e AMSHC si një strukturë e pavarur. Z. Ardian Thano është një person që dukshëm është i pozicionuar pro qeverisë. Kjo ka qenë edhe një nga arsytet pse në kemi zgjedhur zonjen Mira Meksi 4 vjet me parë pikerisht për të pasur një person me reputacion të mosangazhimit. Ndaj dhe mendoj se kjo është një kandidaturë e papershtatshme."

Fjalën e mori anëtari i bordit z. Adrian Thano, i cili sqaroi se:

"Nuk kam angazhim politik, sepse nuk bëj pjesë në asnjë organizatë politike dhe nuk bëj jete partiake. Angazhimi im është qytetar, kam shprehur opinionet e mia si qytetar, jam këtu me propozim të 5 organizatave me të njohura të medias në vend, pra i propozuar nga shoqëria civile".

Kandidatura e z. Adrian Thano për t'u zgjedhur në pozicionin e kryetarit të Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së, u mbështet edhe nga dy anëtarët e tjerë të këtij bordi, e konkretisht znj. Majlinda Dhuka dhe znj. Gelardina Prodani.

Më pas, bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 10 093 datë 09.03.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", I ndryshuar, si dhe në nenin 11, pika 6, e VKM nr. 769 datë 15.07.2009 "Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", e ndryshuar, u kalua në votimin e kandidaturës së z. Adrian Thano, e cila u krye me votim të fshehtë.

Në këtë votim nuk mori pjesë anëtari i Bordit Mbikëqyrës z. Adrian Thano.

Në përfundim të këtij votimi rezultoi:

Gjashtë vota "**pro**" kandidaturës së z. Adrian Thano, për tu zgjedhur në postin e Kryetarit të Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së;

Më pas e mori fjalën Kryetari i sapo zgjedhur i Bordit Mbikëqyrës, z. Adrian Thano, i cili parashtroi:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

- *Falënderoj anëtarët e bordit për mbështetjen dhe besimin që më dhanë, për zgjedhjen time në pozicionin e kryetarit.*
- *Tani kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, në zgjedhjen e zëvendëskryetarit të Bordit Mbikëqyrës, referuar nenit 11 të ligjit nr. 10 093 datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, I ndryshuar.*
- *Ka ndonjë nga anëtarët prezent, një propozim konkret se kush nga anëtarët e këtij bordi do të jetë në pozicionin e zëvendëskryetarit ?*

Fjalën e mori anëtarja e bordit, znj. Gelardina Prodani, e cila tha:

- *Propozoj që znj. Majlinda Dhuka, të jetë në pozicionin e zëvendëskryetarit të këtij bordi.*

Kandidatura e znj. Majlinda Dhuka për tu zgjedhur në pozicionin e zëvendëskryetarit të Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së, u mbështet edhe nga dy anëtarët e tjera të këtij bordi, e konkretisht znj. Elira Kokona dhe znj. Itena Ndroqi.

Më pas, bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 10 093 datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, I ndryshuar, si dhe në nenin 11, pika 6, e VKM nr. 769 datë 15.07.2009 “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, e ndryshuar, u kalua në votimin e kandidaturës së znj. Majlinda Dhuka, e cila u krye me votim të fshehtë.

Në këtë votim nuk mori pjesë anëtari i Bordit Mbikëqyrës, znj. Majlinda Dhuka.

Në përfundim të këtij votimi rezultoi:

Shtatë vota “pro” kandidaturës së znj. Majlinda Dhuka, për tu zgjedhur në postin e Zëvendëskryetarit të Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së;

Znj. Majlinda Dhuka falënderoi anëtarët për besimin dhe votimin e saj në pozicionin e zëvendëskryetarit të këtij bordi.

Fjalën e mori Kryetari i Bordit, z. Adrian Thano, i cili tha:

- Me zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Bordit Mbikëqyrës, e deklarojmë për sot mbledhjen të mbyllur.
- Referuar përcaktimeve ligjore në fuqi, të gjithë anëtarët e bordit mbikëqyrës do të njoftohen për mbledhjen e ardhshme në kohë dhe rregullisht.
- Duke ju falënderuar dhe uruar punë të mbarë, e deklaroj këtë mbledhje të mbyllur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Kryetari

Adrian THANO

Anëtar

Lutfi DERVISHI

Anëtar

Delina NANO

Anëtar

Altin GOXHAJ

Anëtar

Majlina DHUKA

Anëtar

Itena NDROQI

Anëtar

Gelardina PRODANI

Anëtar

Elira KOKONA